



Prishtinë, 10 shtator 2010

Kodi i ZRRE-së: V\_282\_2010

### Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) të dhëna në dispozitat e Neneve 15.2 dhe 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë të ndryshuar me Ligjin Nr.03/L-080;
2. Dispozitat e Nenit 49.2 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë;
3. Kërkesën e Ngrohtores së Qytetit Gjakova Sh.A (N.Q Gjakova Sh.a) për derogim në zbatimin e disa dispozitave të Licencave të N.Q Gjakova Sh.a-së, të datës 19 korrik 2010,

**Në mbledhjen e mbajtur më 10 shtator 2010 nxori këtë:**

### VENDIM

**I LEJOHET** N.Q Gjakova Sh.a-së derogimi (shtyrje afati) në zbatimin e disa neneve dhe dispozitave të:

- Licencës për Gjenerim të Ngrohjes Qendrore dhe
- Licencës për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes së Ngrohjes Qendrore

1. Të gjitha Nenet dhe dispozitat tjera të licencave të N.Q Gjakova Sh.a-së mbesin në fuqi.
2. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
3. Vendimi hyn në fuqi datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
4. Vendimit i bashkëngjitet Shtojca me dispozitat dhe Nenet e deroguara.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente, brenda katërmëdhjetë (14) ditëve, nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

### Bordi i ZRRE-së

---

Dr. Ali Hamiti, Kryesues

---

Përparim Kabashi, Anëtar

---

Theranda Beqiri, Anëtare

---

Blerim Koci, Anëtar

---

**Shtojcë: Nenet e deroguara (shtyrje afati) me datë 10 shtator 2010 të licencave të N.Q Gjakova Sh.a**

<b>Licenca e Gjenerimit e Ngrohtores Qendrore</b>						
Nr	Neni	Derogimi i datës 15.08.08 deri me:	Derogimi i datës 27.05.09 deri me:	Derogimi i datës 24.03.10 deri me:	Derogimi i datës 10.09.10 deri me:	Vërejtje nga ZRRE
1	Neni 8 - Mjedisi	31 dhjetor 2008	30 shtator 2009	30 qershor 2010	31 dhjetor 2010	Obligohet N.Q Gjakova që të angazhohet në përmbushjen e këtij neni, në përputhje me derogimin e lejuar.
2	Neni 11 - Obligimi i Sigurimit	31 dhjetor 2008	30 shtator 2009	30 qershor 2010	31 dhjetor 2010	Obligohet N.Q Gjakova që të angazhohet në përmbushjen e këtij neni, në përputhje me derogimin e lejuar.
<b>Licenca për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes së Ngrohjes Qendrore</b>						
Nr	Neni	Derogimi i datës 15.08.08 deri me:	Derogimi i datës 27.05.09 deri me:	Derogimi i datës 24.03.10 deri me:	Derogimi i datës 10.09.10 deri me:	Vërejtje nga ZRRE
1	Neni 12.1-Standardet e Sigurisë së Sistemit të Shpërndarjes dhe Planifikimit	31 dhjetor 2008	30 shtator 2009	30 qershor 2010	31 dhjetor 2010	Obligohet N.Q Gjakova që të angazhohet në përmbushjen e këtij neni, në përputhje me derogimin e lejuar.